



# TRAJTIMI FISKAL I OJF-VE

VLERËSIM I KUADRIT LIGJOR PËR  
ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE  
NË SHQIPËRI, DHE ZBATIMIT TË TIJ  
NË PRAKTIKË

**2018**

© 2018, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky publikim u përgatit nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në kuadër të projektit: “Mjedis mundësues – OSHC të qëndrueshme” mundësuar nga IBON International nëpërmjet CSO Partnership for Development Efficiency (CPDE), si pjesë e programit “Advokimi mbi Mjedisin Mundësues për OSHC-të”.

Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionet e IBON International.

Partnerët Shqipëri falenderon përfaqësuesit e institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile për bashkëpunimin dhe kontributin në përgatitjen e këtij raporti.

## Përgatitur nga:

Juliana Hoxha

Anora Topi

Klotilda Tavani

## Tabela e Përmbajtjes:

<b>Hyrje .....</b>	<b>4</b>
<b>Metodologjia.....</b>	<b>5</b>
<b>1. Njohja e OJF-ve.....</b>	<b>6</b>
1.1 <i>Llojet e OJF-ve .....</i>	6
1.2 <i>Aktiviteti i OJF-ve dhe burimet e të ardhurave.....</i>	6
1.3 <i>Të dhëna mbi madhësinë e sektorit të OJF-ve.....</i>	7
<b>2. Trajtimi fiskal i OJF-ve dhe ndryshimet kryesore në legjislacion ndër vite.....</b>	<b>10</b>
<b>3. Trajtimi fiskal i aktivitetit ekonomik të OJF-ve .....</b>	<b>13</b>
<b>4. Rimbursimi i TVSH-së së paguar për mallra dhe shërbime të furnizuara në kuadër të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian apo donatorë të tjerë .....</b>	<b>15</b>
<b>5. Taksa të tjera të aplikueshme për OJF-të .....</b>	<b>18</b>
5.1 <i>Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore .....</i>	18
5.2 <i>Taksat dhe tarifat lokale.....</i>	18
<b>6. Trajtimi fiskal i dhurimeve të biznesit dhe individëve ....</b>	<b>21</b>
<b>7. Kërkesat për raportim nga ana e OJF-ve.....</b>	<b>22</b>
<b>8. Detyrimet e OJF-ve ndaj Administratës Tatimore .....</b>	<b>23</b>
<b>9. Kontrollat Fiskale për OJF-të .....</b>	<b>25</b>
9.1 <i>Kontrolli operacional.....</i>	25
9.2 <i>Kontrolli kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.....</i>	25

## Hyrje

Shoqëria civile është një faktor i rëndësishëm në avancimin e zhvillimit demokratik të Shqipërisë. Ajo luan një rol kyç në edukimin publik, përfaqëson një mjet të pazëvendësueshëm për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe monitorimin e performancës së qeverisë. Pavarësisht kësaj, ende organizatat e shoqërisë civile në vend kanë mungesë kapacitetesh njerëzore dhe financiare si dhe përballen me sfida që i përkasin kuadrit ligjor dhe rregullator gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të luajtur plotësisht rolin e tyre në zhvillimin demokratik të vendit.

Në kuadër të punës së saj për krijimin e një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Shqipëri, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim përgatiti një raport monitorimi mbi kuadrin ligjor dhe rregullator fiskal të organizatave jofitimprurëse (në vijim OJF) dhe zbatimin e tij<sup>1</sup> në praktikë.

Megjithëse sektori ka për rreth tre dekada që kryen aktivitet, korniza ligjore e rregullatore e tij është ende në zhvillim, duke shënuar ndryshime shumë të shpeshta të cilat në shumicën e rasteve nuk kalojnë nëpër një proces konsultativ të hapur dhe me pjesëmarrje. Sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve<sup>2</sup> për vitin 2016, qëndrueshmëria e përgjithshme e OSHC-ve në Shqipëri nuk ka bërë hapa përpara.

Qëllimi i këtij raporti është të japë një pasqyrë të përgjithshme mbi legjislacionin fiskal për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri dhe zbatimin e tij, për të identifikuar boshllëqet në kuadrin ligjor dhe sfidat e hasura në praktikë, si dhe për të dhënë rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

Raporti u zhvillua në kuadër të projektit “Mjedisi mundësues - OSHC të Qëndrueshme” të mbështetura nga IBON International përmes CSO Partnership for Development Efficiency (CPDE), në kuadër të programit «Advokimi mbi Mjedisin Mundësues për OSHC-të».

<sup>1</sup> Ligji që rregullon themelimin dhe funksionimin e organizatave të shoqërisë civile në vend është Ligji nr. 8788, datë 17.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”. Prandaj, raporti fokusohet vetëm tek OJF-të. Llojet e tjera të organizatave të shoqërisë civile si sindikatat, organizatat fetare, dhomat e tregtisë e më gjerë, nuk janë subjekt i analizës pasi ato rregullohen përmes ligjeve të tjera dhe trajtimi i tyre fiskal ndryshon nga ai i OJF-ve.

<sup>2</sup> 2016 Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe Euroazinë

## Metodologjia

Partnerët Shqipëri përdorën disa metoda për përgatitjen e këtij raporti gjatë periudhës janar-prill 2018, duke përfshirë: hulumtimin e legjislacionit, takimet në grupe të fokusuara, konsultime dhe një sondazh me OJF-të, kërkesat zyrtare për informacion, si dhe intervista me zyrtarë publikë.

Për përgatitjen e këtij raporti u zhvillua një rishikim gjithëpërfshirës i legjislacionit tatimor të aplikueshëm për organizatat jofitimprurëse, dhe zbatimi i tij. Ky rishikim mbuloi një gamë të gjerë burimesh: legjislacionin, të dhënat publike dhe raportet e publikuara nga institucionet publike, dhe raporte të ndryshme të shkruara nga shoqëria civile në Shqipëri apo organizatat ndërkombëtare. Gjithashtu u konsultuan burime ndërkombëtare për të krahasuar situatën shqiptare me praktikatat e tjera në rajon dhe jashtë saj.

Për të mbledhur dhe analizuar informacione në lidhje me përvojat e tyre me çështjet e taksave, u krye edhe një sondazh me organizatat jofitimprurëse. Qëllimi i pyetësorit të standartizuar ishte shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me trajtimin fiskal duke marrë informacion kryesisht mbi aktivitetin e OJF-ve, burimet e të ardhurave dhe trajtimin fiskal. Katër takime konsultative rajonale me organizatat lokale të shoqërisë civile në Tiranë, Kukës dhe Vlorë kontribuan gjithashtu në të kuptuarit e situatës në tërësi dhe problematikave me të cilat përballen organizatat jofitimprurëse sa i përket trajtimit fiskal.

Gjithashtu, u kryen intervista me zyrtarë publikë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe Administratës Tatimore. Së fundmi, për shkak të mungesës së të dhënave të publikuara për këtë sektor, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare për informacion në disa institucione publike si: Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, dhe Ministrinë e Linjës.

## 1. Njohja e OJF-ve

### 1.1. Llojet e OJF-ve

Kushtetuta shqiptare i njuh të drejtën çdo qytetari për tu organizuar kolektivisht për çdo qëllim legjitim. Gjithashtu ajo parashikon që regjistrimi i organizatave të bëhet në gjykatë sipas një procedure të përcaktuar me ligj<sup>3</sup>.

Ligji primar që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse që kryejnë aktivitete në të mirën dhe interesin e publikut, është Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse". Sipas tij, çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj mund të regjistrojë një organizatë jofitimprurëse. Ligji njuh tre lloje organizatash jofitimprurëse: (1) shoqata, (2) fondacione dhe (3) qendra.

Sipas formës së organizimit të tyre, organizatat jofitimprurëse klasifikohen si:

- OJF-të me anëtarësi (shoqata);
- OJF-të pa anëtarësi (fondacionet dhe qendrat);

Sipas regjistrimit të tyre, organizatat jofitimprurëse klasifikohen si:

- Organizata kombëtare/vendase (të themeluara dhe të regjistruara sipas ligjit shqiptar);
- Organizata ndërkombëtare (të themeluara dhe të regjistruara sipas ligjit të një vendi të huaj por të regjistruara sipas ligjit shqiptar gjatë ushtrimit të veprimtarisë në Shqipëri);

Organizatat jofitimprurëse, subjekt i Ligjit nr. 8788 e fitojnë aftësinë juridike pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj. Degët e organizatave jofitimprurëse të huaja gjithashtu i nënshtrohen të njëjtave procedura regjistrimi. Procedurat për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse në gjykatë dhe depozitimin e dokumenteve të tyre në Regjistrin përkatës rregullohen me Ligjin Nr. 8789, datë 7.05.2001, "Për regjistrimin e OJF-ve".

### 1.2. Aktiviteti i OJF-ve dhe burimet e të ardhurave

OJF-të kryejnë aktivitetet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti. Për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së parashikuar në statut, organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të ushtrorjnë çfarëdo lloj aktiviteti të ligjshëm. Siç parashikohet në Ligjin nr. 8788, "Për Organizatat Jofitimprurëse", aktiviteti jofitimprurës nënkupton çdo aktivitet ekonomik ose jo ekonomik me kusht që të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, nëse ka, përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve të specifikuar në statutin e organizatës<sup>4</sup>.

Burimet e të ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës<sup>5</sup>. Organizatat jofitimprurëse, si çdo subjekt tjetër juridik, kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e tenderimit dhe prokurimit të granteve, kontraktimit dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 26, Pikat 1 dhe 2

<sup>4</sup> Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse", Neni 2

<sup>5</sup> Idem, Neni 35

OJF-të kanë të drejtë të organizojnë aktivitete për mbledhjen e fondeve në përmbushje të qëllimit dhe objektit të aktivitetit të tyre ose për të mbështetur qëllimet dhe aktivitetet e organizatave të tjera jofitimprurëse. Ligje të veçanta përcaktojnë rregullat për grumbullimin e fondeve. Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët përcaktohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e statutit të organizatës jofitimprurëse dhe të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”.

Burimet primare të financimit për OJF-të janë nga tarifat e anëtarësimit, grantet dhe donacionet, ndërkohë organizatat jofitimprurëse përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga këto lloje financimi<sup>6</sup>. Përveç kësaj, për këto lloje financimi, OJF-të nuk konsiderohen “person i tatueshëm” sipas përkufizimit në Ligjin për TVSH-në<sup>7</sup>, rrjedhimisht ato janë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin dhe TVSH-ja.

Nëse OJF-të kryejnë veprimtari ekonomike për të gjeneruar të ardhura për të përmbushur qëllimet e përcaktuara në statut dhe aktin e themelimit, ato konsiderohen “person i tatueshëm”. Aktiviteti ekonomik NUK duhet të jetë aktiviteti primar i OJF-ve (aktiviteti jo-ekonomik duhet të mbizotërojë) dhe të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore. Nëse kjo shumë tejkalon kufirin e regjistrimit në TVSH prej 2 milionë lekë, atëherë OJF-të, si çdo person tjetër i tatueshëm duhet të regjistrohen dhe të deklarohen TVSH-në, sipas Ligjit për Proçedurat Tatimore i ndryshuar në vitin 2018<sup>8</sup>.

### 1.3. Të dhëna mbi madhësinë e sektorit të OJF-ve

Të dhënat për numrin e OJF-ve në vend vazhdojnë të jenë të paqarta, kjo për shkak të mungesës së një regjistri elektronik të unifikuar dhe të përditësuar të OJF-ve në nivel kombëtar. Të gjitha OJF-të e reja duhet të regjistrohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës. Ky proces vlerësohet si problematik dhe ka krijuar shumë pengesa financiare dhe administrative për ata që dëshirojnë të krijojnë një OJF<sup>9</sup>. Për më tepër, OJF-të nuk mund të krijojnë marrëdhënie financiare nëse nuk kanë një llogari bankare, hapja e të cilës domosdoshmërisht kërkon regjistrimin pranë autoritetit tatimor.

Ekziston një mospërputhje e madhe në të dhënat e ofruara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës me ato të raportuara nga Administrata Tatimore sa i përket OJF-ve. Ndërsa numri i OJF-ve të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë është 7,383, vetëm 4,136 raportohet të jenë regjistruar në Administratën Tatimore dhe prej tyre vetëm 2,032 OJF (rreth 50% në total) janë në regjistrin e tatimpaguesve aktivë<sup>10</sup> (shih grafikun nr.1)<sup>11</sup>. Siç tregohet në grafikun 2, Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës raporton gjithashtu se në vitin 2017 janë regjistruar 345 OJF të reja (198 Shoqata, 61 Fondacione dhe 86 Qendra), ndërsa vetëm 238 janë regjistruar në Administratën Tatimore në të njëjtin vit.

Problematika kryesore sa i përket të dhënave të sakta për këtë sektor janë si më poshtë:

- Informacioni nga Administrata Tatimore nuk është plotësisht i saktë, për shkak të përzjerjes së OJF-ve me subjektet e tjera në regjistrat e tyre, si universitete, parti politike etj.
- Regjistri elektronik i administratës tatimore i është nënshtruar disa ndryshimeve (nga regjistrimi manual i të dhënave që në krijimin e institucionit, e më pas me zhvillimin e sistemit TIK i cili ka ndryshuar dy herë), situatë e cila ka krijuar probleme në klasifikimin e tatimpaguesve të regjistruar ndër vite, veçanërisht për OJF-të.

<sup>6</sup> Idem, Neni 40

<sup>7</sup> Ligji 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar

<sup>8</sup> Ndryshimi i kufirit të regjistrimit për TVSH, u kundërshtua fuqishëm nga përfaqësuesit e biznesit të vogël në Shqipëri pasi krijon barrierë të pajtueshmërisë. Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal dhe procedurat përkatëse kanë ndikuar negativisht të gjithë sistemin. Shqipëria ka humbur pikë konsiderueshëm në Doing Business 2018 sa i takon pagimit të taksave krahasuar me vitin e kaluar. Linku: <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/albania#pay-ing-taxes>


<sup>9</sup> <http://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>

<sup>10</sup> Sipas dispozitave të Ligjit nr. 9920, “Për Proçedurat Tatimore”, “tatimpaguesit aktivë” janë ata që kanë deklaruar të paktën një deklaratë tatimore brenda 12 muajve të fundit të njëpasnjëshëm. Në rastet kur organizata: (1) nuk kryen asnjë aktivitet për 12 muaj rresht, (2) nuk paraqet asnjë deklaratë tatimore për një periudhë prej 12 muajsh rresht ose (3) deklarën pezullimin e veprimtarisë së saj në autoritetet tatimore, ajo kalon automatikisht në regjistrin pasiv të tatimpaguesve. Kur kalon në regjistrin pasiv, organizata nuk ka asnjë detyrim të paraqesë çfarëdo deklarate tatimore dhe nuk aplikohen penalitete për mosdeklarim

<sup>11</sup> Të gjitha të dhënat janë bazuar në përgjigjet zyrtare nga institucionet përkatëse, me kërkesë të Partnerëve Shqipëri


## Grafiku nr. 1

Të Dhëna mbi Regjistrimin e OJF-ve



## Grafiku nr. 2


OJF të Regjistruara në 2017





Sa i përket shpërndarjes së OJF-ve të regjistruara në Administratën Tatimore nëpër qytete, është e qartë se numri më i madh i OJF-ve të regjistruara ndodhet në Tiranë, pasuar nga Shkodra, Durrësi, Elbasani dhe Korça (shih grafikun nr.3).

### Grafiku nr. 3



#### [Rekomandime:]

- Siç evidentohet nga kontradiktat në të dhënat e raportuara, është e vështirë të njihet sektori në një situatë ku ende nuk ka një regjistër të unifikuar elektronik të OJF-ve, të aplikueshëm nga të gjitha institucionet relevante përgjegjëse për regjistrimin dhe rregullimin e aktivitetit të OJF-ve. Prandaj, si hap i parë në përpjekjet për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e OJF-ve në vend, mbetet përgatitja dhe publikimi i një baze të dhënash gjithëpërfshirëse që ofron informacion mbi OJF-të si: numri i tyre, fusha e veprimit, shpërndarja gjeografike, forma ligjore, numri i të punësuarve dhe vullnetarëve, qarkullimi vjetor, burimet e financimit etj.
- Krijimi i një regjistri të veçantë elektronik vetëm për OJF-të (siç përcaktohet në ligjin për OJF-të) brenda Administratës Tatimore. Ai jo vetëm që do të sigurojë informacion të saktë për sektorin, por do të lejojë gjithashtu një trajtim të diferencuar tatimor të OJF-ve në përputhje me natyrën e tyre jofitimprurëse dhe llojin e veprimtarisë. Regjistri do të mundësonte matjen e ndikimit dhe kontributin e sektorit në zhvillimin ekonomik të vendit.

## 2. Trajtimi fiskal i OJF-ve dhe ndryshimet kryesore në legjislacion ndër vite

Trajtimi fiskal i OJF-ve mbetet problematik dhe paraqet një pengesë të madhe në funksionimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e tyre.

Që nga viti 2001, kur u miratua Ligji për OJF-të, janë bërë shumë ndryshime në kuadrin ligjor për trajtimin fiskal të tyre, në disa raste pa konsultime me sektorin, ose pa marrë në konsideratë sugjerimet e ekspertëve. Si rezultat, duke qenë se kuadri rregullator fiskal nuk është përgatitur siç duhet në bazë të natyrës dhe misionit të OJF-ve, zbatimi i tij në praktikë është i paqartë dhe i keqinterpretuar si nga autoritetet tatimore ashtu dhe OJF-të.

Në ligjin për OJF-të të miratuar në vitin 2001, përcaktohet që organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma e organizimit, misioni dhe llojet e veprimtarisë, janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat për dhurimet dhe kuotat e anëtarësimit<sup>12</sup>, duke lënë jashtë grantet dhe llojet e tjera të të ardhurave të krijuara nga OJF-të përmes aktivitetit të tyre jo-ekonomik. Ligji njih të drejtën e OJF-ve për të kryer aktivitete ekonomike për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të misionit të tyre, por asnjë dispozitë nuk u parashikua në këtë ligj apo ligje të tjera mbi raportin e aktivitetit ekonomik me aktivitetin e përgjithshëm të OJF-ve, duke e lënë atë të paqartë në terma të trajtimit fiskal dhe raportimit tek autoritetet shtetërore.

Mangësitë në Ligjin për OJF-të si dhe ligjet dhe rregulloret e tjera lidhur me trajtimin fiskal të OJF-ve, çuan në klasifikimin e granteve si të ardhura të tatueshme në ligjin e TVSH-së në vitin 2008. Si rezultat, pas miratimit të një qarkoreje nga administrata tatimore për aplikimin e TVSH-së për organizatat jofitimprurëse, të gjitha OJF-të u regjistruan automatikisht në TVSH dhe Tatimin mbi Fitimin, duke i klasifikuar OJF-të si “biznes i madh”, në kundërshtim të plotë me natyrën dhe definicionin e tyre: Jo-fitimprurës - jo tatim mbi fitimin. Bazuar në këtë qarkore, autoritetet tatimore filluan inspektime dhe kontrole të ndryshme tatimore për sektorin.

Në anën tjetër, kjo dispozitë u keqinterpretua edhe nga donatorët, të cilët filluan të kërkojnë fatura biznesi (faturat e TVSH-së) të lëshuara nga OJF-të për kontratat e granteve duke krijuar kështu barrë të lartë për sektorin. Sektori u përball me disa implikime negative, siç ishin: mbyllja e OJF-ve, rritja e kostove të pajtueshmërisë, gjobat e vendosura nga autoritetet tatimore për çështjet që lidheshin me deklarin dhe pagesën e taksave, kosto shtesë në zbatimin e projekteve të financuara nga donatorët, etj.

Me ndryshimet e ndodhura në vitin 2013 në ligjin e OJF-ve, u bënë përmirësime në lidhje me sqarimin e «granteve» dhe «aktivitetit ekonomik». Sipas këtyre ndryshimeve, u dha një përkufizim më i qartë për këto terma, por ende mbeti i paqartë raporti midis aktivitetit ekonomik dhe aktivitetit jo-ekonomik të OJF-së<sup>13</sup>. Një tjetër ndikim pozitiv i këtyre ndryshimeve ishte përjashtimi nga tatimi i “granteve” dhe “interesave bankare”. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve, situata lidhur me regjistrimin e OJF-ve në TVSH dhe Tatimin mbi Fitimin nuk ndryshoi deri në vitin 2015.

Shoqëria civile, me përpjekjet e saj të vazhdueshme, ka luajtur një rol kyç në përmirësimin e legjislacionit për sektorin. Trajtimi fiskal i OJF-ve ishte një nga tri shtyllat kryesore të dialogut midis OJF-ve dhe Qeverisë Shqiptare në Konferencën Kombëtare “Partnerët Socialë - Koha për Veprim”, organizuar nga Partnerët Shqipëri në Dhjetor 2013. Konferenca u përmyll me një Deklaratë të Përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në Shqipëri dhe angazhimin e qeverisë për të punuar me ekspertët e shoqërisë civile për të adresuar çështjet e deklaratës. Si rezultat, Ligji i ri për TVSH-në në Shqipëri që u miratua në vitin 2015 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave për zbatimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nr. 953, datë 29.12.2014, më në fund siguroi dispozita të qarta për sektorin, si vijon:

<sup>12</sup> Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, “Per Organizatat Jofitimprurëse”, Neni 40

<sup>13</sup> Ligji 92/2013 për disa ndryshime dhe shtesa të Ligjit 92/2013, Neni 1


- Grantet përjashtohen nga TVSH-ja;
- Qarkullimi nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojë 20% të qarkullimit total vjetor;
- Përcaktimi i qartë i kufirit për regjistrimin në TVSH. Ligji i ri sqaron dhe konfirmon përjashtimin e OJF-ve nga TVSH-ja, ndaj duke filluar nga 2015 asnjë prej tyre nuk është regjistruar automatikisht në TVSH apo Tatim mbi Fitimin.

Por situata mbetet problematike me OJF-të që janë regjistruar në TVSH në periudhën 2008-2014 dhe vazhdojnë të jenë në sistem, duke krijuar konfuzion të madh midis OJF-ve, autoriteteve tatimore dhe komunitetit të donatorëve lidhur me sektorin herë Brenda dhe herë Jashtë skemës së TVSH-së.

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, 1,348 OJF (ose 60% e sektorit) janë të regjistruara në TVSH dhe shumica e tyre nuk kanë kryer ndonjëherë aktivitet ekonomik, ndërsa rreth 1,043 organizata jofitimprurëse janë regjistruar në Tatimin mbi Fitimin në regjistrin e të dhënave të Administratës Tatimore (shih grafikun nr.4 dhe 5).


### Grafiku nr. 4

Regjistrimi i OJF-ve në Skemën e TVSH-së



### Grafiku nr. 5

Regjistrimi i OJF-ve për Tatimin mbi Fitimin



Duke qenë se kjo përfaqëson një barrë të pajustificuar financiare dhe administrative për OJF-të, ka qenë një nga çështjet kryesore të diskutimeve mes ekspertëve të shoqërisë civile dhe Ministrisë së Financave në Konferencën Kombëtare: "Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri"<sup>14</sup> organizuar nga Zyra e Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) në dhjetor 2016.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave pranoi se regjistrimi i OJF-ve në TVSH nuk ka qenë korrekt, por gjithashtu deklaroi se ekziston një procedurë për çregjistrim bazuar në një kërkesë të paraqitur nga OJF-të tek autoritetet tatimore. Kjo deklaratë mbështetet nga intervistat me administratën tatimore gjatë përgatitjes së këtij raporti dhe informacioni i dhënë në përgjigje të kërkesës të paraqitur nga Partnerët Shqipëri për numrin e OJF-ve të çregjistruara nga TVSH-ja. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, janë 35 OJF që janë çregjistruar nga TVSH-ja në periudhën 2016-2017, dhe procedura për çregjistrim bazohet në ligjin për TVSH-në dhe udhëzimin e tij.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> <http://www.tacso.org/Publication/ArchiveRead/14590?title=Albania:%20National%20Conference%20on%20Enabling%20Environment%20for%20CSOs%20in%20Albania>

<sup>15</sup> Ligji nr. 92/2014 "Për TVSH në Republikën e Shqipërisë", Neni. 12, dhe Udhëzimi nr. 6 /30.01.2015, Neni. 6

## Por, çfarë parashikon ligji në lidhje me procesin e çregjistrimit nga TVSH-ja?

**Së pari**, neni 122 i Ligjit nr. 92/2014 për “Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i referohet **bizneseve të vogla** që kërkojnë të çregjistrohen nga TVSH-ja pranë autoritetit tatimor kur qarkullimi i tyre në 12 muajt kalendarik të fundit bie nën kufirin minimal të regjistrimit në TVSH. Nuk ka referencë për OJF-të në këtë nen apo në nene të tjerë të këtij ligji.

**Së dyti**, neni nr. 6, pika c) i Udhëzimit nr. 6/30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i referohet rasteve kur një **“person i tatueshëm”** i regjistruar në TVSH, nuk ka qenë kurrë i detyruar të regjistrohet dhe as nuk ka ushtruar vullnetarisht të drejtën për t’u regjistruar në TVSH, kërkon të çregjistrohet.

Sipas të njëjtit udhëzim, edhe pse një subjekt mund të çregjistrohet **pasi të jetë provuar**<sup>16</sup> se nuk ka qenë i detyruar apo nuk e ka ushtruar vullnetarisht të drejtën për t’u regjistruar në TVSH, ai është ende përgjegjës për deklarimin dhe pagesën e TVSH-së që nga momenti i regjistrimit deri në datën e çregjistrimit nga TVSH-ja. Ky nuk është rasti i OJF-ve që janë regjistruar automatikisht nga autoritetet tatimore në TVSH.

Duke marrë parasysh sa më sipër, është e qartë se nuk ka bazë ligjore për çregjistrimin e OJF-ve nga TVSH-ja, duke vënë një pikëpyetje për numrin e OJF-ve të çregjistruara nga TVSH-ja të raportuara nga Administrata Tatimore. Marrë në konsideratë sa më sipër, mund të konstatohet se aktualisht ekziston një numër i madh i OJF-ve ende të regjistruara në sistemin e TVSH-së, edhe pse nuk kanë kryer asnjë aktivitet ekonomik.

### [Rekomandime:]

- Përgatitja e udhëzimeve për trajtimin fiskal të OJF-ve, për të shërbyer si një dokument orientues për inspektorët tatimorë, OJF-të dhe çdo palë tjetër të interesuar për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi. Ky dokument do të jetë i dobishëm për inspektorët tatimorë në punën e tyre sa i përket trajtimit fiskal të organizatave jofitimprurëse, si dhe do të përdorej gjithashtu si një material “zyrtar” ku të mund të bazohen edhe donatorët.
- Për të sqaruar çështjen e çregjistrimit nga TVSH-ja rekomandohet që Administrata Tatimore të përgatisë një procedurë të veçantë për çregjistrimin e të gjitha OJF-ve nga sistemi i TVSH-së. Procedura duhet të referohet në legjislacionin përkatës dhe të publikohet, shoqëruar me udhëzime specifike për strukturat përgjegjëse për zbatimin e saj. Trajnime të përfaqësuesve të OJF-ve dhe inspektorëve tatimorë do të jenë të nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj procedure.

<sup>16</sup> Administrata Tatimore ka të drejtë të kontrollojë dokumentacionin e regjistrimit të subjektit si dhe dokumentet e tjera të lidhura me aktivitetin për të siguruar provën e nevojshme për një vendim përfundimtar.

### 3. Trajtimi fiskal i aktivitetit ekonomik të OJF-ve

Siç është përmendur në seksionin e mëparshëm, **OJF-të mund të kryejnë aktivitete ekonomike** për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të misionit të tyre. Dhe si çdo entitet tjetër që kryen veprimtari ekonomike, pavarësisht nga forma e tyre e organizimit, OJF-të konsiderohen “person i tatueshëm” dhe kërkohet të regjistrohen për tatimin mbi fitimin, sipas dispozitave të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Nëse qarkullimi vjetor nga aktiviteti ekonomik është më i madh se 2 milionë Lek ata duhet të regjistrohen në TVSH<sup>17</sup>.

Sipas përcaktimit të Ligjit mbi TVSH-në, aktivitet ekonomik konsiderohet “çdo aktivitet i kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, duke përfshirë aktivitetet nxjerrëse, bujqësore dhe profesionale. Aktivitet ekonomik gjithashtu konsiderohet të jetë përdorimi i aseteve të paluajtshme me qëllim gjenerimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm”<sup>18</sup>.

Ashtu si çdo subjekt i tatueshëm, OJF-ve u lind e drejta për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së për aktivitetin e tyre ekonomik, nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin e TVSH-së<sup>19</sup>:

- ka tepriçë kreditore të TVSH-së për tre muaj rresht;
- shuma e TVSH-së së kërkuar duhet të tejkalojë 400,000 Lek.

Duke marrë parasysh natyrën jofitimprurëse të OJF-ve dhe kufizimet e paraqitura në ligjet përkatëse për nivelin e aktivitetit ekonomik të kryer (aktiviteti ekonomik është aktivitet dytësor i OJF-ve dhe të ardhurat vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të kalojnë 20% të të ardhurave totale vjetore), është evidente që aktiviteti ekonomik i OJF-ve nuk mund të ketë karakter të vazhdueshëm. Si rezultat, ato nuk mund të plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, duke e bërë praktikisht të pamundur që OJF-të të përfitojnë rimbursim.

OJF-të gjithashtu kanë të drejtë të përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së për disa aktivitete ekonomike që konsiderohen si «aktivitete me interes të publikut»<sup>20</sup>. Për të përfituar përjashtimin nga TVSH-ja për këto lloj aktivitetesh, OJF-të duhet të plotësojnë tre kriteret si më poshtë, të përcaktuara me Vendimin nr. 953 të Këshillit të Ministrave, datë 29.12.2014:

1. Organet vendimmarrëse të OJF-ve nuk duhet të kenë interesa të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës;
2. Aktiviteti jo-ekonomik i organizatës duhet të mbizotërojë në mënyrë të dukshme në raport me pjesën tjetër të aktiviteteve. Aktiviteti ekonomik nuk mund të kalojë 20% të të ardhurave vjetore të organizatës jofitimprurëse.
3. Produktet apo shërbimet e ofruara nga OJF-të nuk duhet të konkurrojnë me sektorin fitimprurës. OJF-të që plotësojnë këto kritere duhet të paraqesin një kërkesë së bashku me listën e dokumenteve të kërkuara<sup>21</sup> pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse për përjashtimin nga TVSH. Vendimi për përjashtimin nga TVSH miratohet dhe firmoset nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore, për një periudhë tre vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

<sup>17</sup> Ligji nr. 9920, 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar

<sup>18</sup> Ligji nr 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në republikën e Shqipërisë”, Neni 4

<sup>19</sup> Neni 77, Ligji 92/2014 si dhe Udhëzimi nr. 6

<sup>20</sup> Ligji nr 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në republikën e Shqipërisë”, Neni 51

<sup>21</sup> Lista e dokumenteve përfshin: Vendimin e Gjykatës; Statuti dhe akti i themelimit; një listë me të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrohen së bashku me çmimet; deklaratën e misionit dhe qëllimeve të OJF-ve, si dhe programet kryesore; deklaratat e përfituesve apo grupeve në nevojë që shërben OJF-ja; burimet e të ardhurave, përfshirë përqindjen e të ardhurave që rrjedhin ose që priten nga aktiviteti ekonomik.

Në kuadër të përgatitjes së këtij raporti, Partnerët Shqipëri paraqiti një kërkesë pranë Administratës Tatimore lidhur me numrin e OJF-ve që kanë kërkuar përjashtim dhe që e kanë përfituar atë në bazë të kriterëve dhe procedurave të ligjit, por ky informacion nuk u ofrua.

### **[Rekomandime:]**

- Duke marrë parasysh që skema e rimbursimit të TVSH-së për veprimtarinë ekonomike të OJF-ve nuk është e zbatueshme për arsyet e përmendura më lart, rekomandohet rishikimi i skemës dhe prezantimi i një procedure të re për OJF-të që të mund të marrë parasysh natyrën e tyre jofitimprurëse dhe karakterin e veçantë të aktivitetit të tyre ekonomik.
- Rishikimi dhe zgjerimi i llojit të aktiviteteve që konsiderohen si “me interes të gjerë publik” dhe që janë të përjashtuara nga TVSH, përfshirë llojet e tjera të veprimtarive të kryera nga OJF-të që i shërbejnë interesit të përgjithshëm publik.

## 4. Rimbursimi i TVSH-së së paguar për mallra dhe shërbime të furnizuara në kuadër të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian apo donatorë të tjerë

Në parim, të gjitha llojet e granteve dhe donacioneve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Në rastet kur marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë ose marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikojnë mospërdorimin e burimeve financiare të huaja për të paguar taksa, përfshirë ose jo TVSH-në, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar u rimburohet donatorëve të huaj nga Sistemi i Thesarit, brenda 30 ditëve, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri i Financave<sup>22</sup>.

Vetëm për projektet e financuara përmes Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA), ekziston një udhëzim i Ministrisë së Financave miratuar në vitin 2013 për procedurën e rimbursimit të TVSH-së<sup>23</sup>, në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)".


Bazuar në këtë udhëzim, kontraktorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga IPA do të rimburohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore për TVSH-në e paguar për mallrat ose shërbimet e furnizuara në kuadër të këtyre projekteve, pas dorëzimit të aplikimit për rimbursim të TVSH-së dhe dokumenteve të tjera të nevojshme siç parashikohet në këtë Udhëzim. Vetë marrëveshja dhe udhëzimet në mbështetje të zbatimit të saj kanë rezultuar joefektive, pasi deri më tani vetëm një organizatë është rimbursuar, sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Siç tregohet në grafikun 6, ekzistojnë **vetëm 8 (tetë) çertifikata regjistrimi me qëllim rimbursimin e TVSH-së së financiar nga IPA në periudhën 2015-2017** (hapi i parë i procedurës së rimbursimit të TVSH-së është regjistrimi i projektit në Drejtorinë Tatimore Rajonale dhe marrja e certifikatës me qëllim rimbursimin), **vetëm 4 (katër) OSHC kanë aplikuar për rimbursimin e TVSH-së** (pas zbatimit të projektit, OJF-ja i paraqet Autoritetit Tatimor kërkesën për rimbursimin e TVSH-së në lidhje me operacionet që bien nën kontratën e projektit, së bashku me dokumentet mbështetëse siç parashikohet në udhëzim). Tre nga katër aplikime të OSHC-ve për rimbursimin e TVSH-së, janë refuzuar për mos përmbushjen e kritereve ligjore të parashikuara në udhëzim, sipas DPT.

<sup>22</sup> Ligji nr 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në republikën e Shqipërisë", Neni 77, Pikat 2 dhe 5

<sup>23</sup> Udhëzimi nr 4, datë 22.01.2013 i Ministrisë së Financave, "Për disa shtesa në vendimin nr. 17, datë 13.05.2008, Për TVSH, I ndryshuar"

## Grafiku nr. 6



Problematikat kryesore të marrëveshjes dhe udhëzimit që kanë ndikuar në situatën aktuale renditen si mëposhtë:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European (Ligji Nr. 9840, datë 10.12.2007) nuk është gjithëpërfshirëse dhe nuk parashikon rimbursimin e TVSH-së së mekanizmave dhe instrumenteve të tjerë të financimit të BE-së në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, për të cilat OJF-të shqiptare kanë të drejtë të aplikojnë dhe tashmë një numër i konsiderueshëm i tyre janë duke zbatuar projekte të tilla. Për t'u përmendur janë: EIDHR, IPA ndërkufitare, Erasmus +, etj.
- Kërkesa e pa standardizuar, që partnerët e huaj zbatues të projekteve të financuara nga IPA, të themeluar dhe që operojnë në vende të tjera, për t'u regjistruar për qëllime biznesi në Shqipëri, si kusht nga zyrat rajonale tatimore. Meqenëse ky kusht nuk është i qartë në udhëzim, edhe regjistrimi i projektit për rimbursimin e TVSH-së bazohet në interpretimin e inspektorëve tatimorë. Kjo paqartësi në udhëzim ka rezultuar në refuzimin e regjistrimit të projekteve për rimbursimin e TVSH-së nga autoritetet tatimore. Si shembull praktik për të dëshmuar këtë, është rasti i vetë Partnerëve Shqipëri. Partnerët Shqipëri po zbaton dy projekte të financuara me fonde IPA, me organizata partnere të themeluara në Itali. Një projekt me dy organizata italiane si partnerë zbatues është regjistruar për rimbursimin e TVSH-së, ndërsa aplikimi për projektin tjetër me një partner zbatues (një nga organizatat partnere në projektin e parë) është hedhur poshtë vetëm me këtë bazë interpretimi.
- Procedura e rimbursimit është shumë e gjatë në kohë dhe pengon qëndrueshmërinë financiare të OJF-ve. Ato duhet të paguajnë një sasi të konsiderueshme të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera gjatë zbatimit të projektit nga burimet e tyre dhe të aplikojnë për rimbursimin e TVSH-së vetëm pas miratimit të raportit përfundimtar nga Delegacioni Evropian, i cili mund të zgjasë deri në 18 muaj pas zbatimit të projektit.
- Për shkak të riorganizimit të fundit të Administratës Tatimore në Shqipëri në vitin 2016, rimbursimi i TVSH-së është i centralizuar dhe kërkesat shqyrtohen në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, çka do të thotë që OJF-të nga të gjitha qytetet e tjera duhet të dërgojnë të gjitha dokumentet në Tiranë me një kosto shtesë të vlerësuar prej 20-30 mijë Lekë.

Duke e krahasuar këtë situatë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, mund të vërehet lehtësisht se Shqipëria mbetet prapa vendeve të tjera në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe administrativ për trajtimin e TVSH-së për projektet e financuara nga jashtë, përfshirë edhe BE-në. Pothuajse në të gjitha vendet e tjera në rajon (Serbi, Mal i Zi, BH, Maqedoni) aplikohet përrjashtimi nga TVSH, ndërsa në Kosovë rimbursimi i TVSH-së bëhet në baza mujore gjatë zbatimit të projektit<sup>24</sup>.

<sup>24</sup> Për më shumë informacion mbi procedurën në secilin vend, ju lutemi referojuni Udhëzimeve mbi Procedurat e Përrjashtimit të TVSH-së për Projektet e Financuara nga BE në vendet IPA - Janar 2016, të publikuar nga TACSO në: [http://www.tacso.org/data/dokumenti/pdf/doc\\_vat\\_report\\_january2016.pdf](http://www.tacso.org/data/dokumenti/pdf/doc_vat_report_january2016.pdf)



Në një situatë kur donatorët më të mëdhenj në vend, si Bashkimi Evropian dhe Qeveria Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) po zbatojnë gjerësisht skemat e nën-grantimit si pjesë e projekteve të tyre, përveç efekteve pozitive në sigurimin e mbështetjes për OJF-të e vogla lokale përmes kësaj qasjeje, janë krijuar barriera shtesë për qëndrueshmërinë financiare të këtyre OJF-ve. Marrëveshjet përkatëse me Qeverinë Shqiptare për rimbursimin e TVSH-së nuk e kanë parashikuar këtë, dhe si rezultat, nën-grantuesit nuk kanë të drejtë të rimbursohen për TVSH-në e paguar për mallrat ose shërbimet e furnizuara nën këto projekte.

Duke qene se nuk ka bazë ligjore të aplikueshme për rimbursimin e TVSH-së, ky tatim mbetet një kosto shtesë që ata duhet ta paguajnë nga buxhetet e tyre.

### [Rekomandime:]

- Hapi i parë dhe i menjëhershëm për lehtësimin e OJF-ve nga barra e TVSH-së së paguar për mallrat apo shërbimet e ofruara nga BE-ja dhe të gjitha projektet e financuara nga jashtë për të cilat ka marrëveshje financiare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, apo marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave ku tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar rimbursohet për donatorët e huaj, do të ishte hartimi dhe miratimi i një Udhëzimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe dokumenteve të lidhura me të. Ky udhëzim duhet të përfshijë dispozita të qarta për rimbursimin e TVSH-së për OJF-të për të gjitha projektet e financuara nga donatorët e huaj, në mbështetje të zbatimit të Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”, neni 77, pika 2 dhe 5. Udhëzimi duhet të parashikojë rimbursimin e TVSH-së për të gjithë përfituesit, qofshin këta përfitues të drejtpërdrejtë të granteve, partnerë zbatues, apo nën-grantues.
- Hartimi i manualeve të qarta për inspektorët tatimorë për zbatimin korrekt të Udhëzimit të ri, bashkë me trajnime për të siguruar të kuptuarit dhe interpretimin e unifikuar të Udhëzimit si dhe dokumenteve të tjera lidhur me të.
- Organizimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimi dhe sesioneve informuese me sektorin e OJF-ve për të njohur, kuptuar dhe zbatuar procedurën e re.
- Në një fazë të mëvonshme, si zgjidhje përfundimtare e kësaj çështjeje, do të ishte miratimi i procedurës për përjashtimin nga TVSH-ja për të gjitha mallrat dhe shërbimet e ofruara nga OJF-të në kuadër të projekteve të financuara nga BE si dhe projekteve të tjera të financuara, për të cilat ka marrëveshje financiare të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar apo marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat përcaktojnë se tatimi mbi vlerën e shtuar të paguar i rimbursohet donatorit të huaj. Përvojat e mira të vendeve të tjera nga rajoni i Ballkanit Perëndimor do të shërbenin si një model për këtë procedurë.

## 5. Taksa të tjera të aplikueshme për OJF-të

### 5.1. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Bazuar në ligjin për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore<sup>25</sup>, OJF-të, si çdo punëdhënës, duhet të deklarojnë dhe të paguajnë kontribute mujore të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të paktën një punonjës.

Ky detyrim vlen për të gjitha OJF-të, që në fillim të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë organizatat që kryejnë aktivitet bazuar në punën vullnetare të anëtarëve të tyre, duke paraqitur kështu një pengesë reale për iniciativën e lirë të individëve për të themeluar organizata jofitimprurëse dhe për të promovuar vullnetarizmin si një vlerë njerëzore në mbështetje të njerëzve në nevojë. Siç tregohet në grafikun nr.7 mbi detyrimet tatimore të OJF-ve, vështirësitë e sektorit për të përmbushur këtë detyrim kanë krijuar borxhe të konsiderueshme të taksave të papaguara, ose i kanë detyruar ata të kalojnë në status pasiv.

#### [Rekomandime:]

- Propozim për një trajtim të diferencuar të OJF-ve në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore, duke marrë parasysh aktivitetin vullnetar të tyre.

### 5.2. Taksat dhe tarifat lokale

Kuadri ligjor<sup>26</sup> mbi taksat vendore në Shqipëri përcakton të drejtat dhe detyrat e njërive të qeverisjes vendore për të aplikuar taksat vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në një analizë të disa taksave vendore të aplikuara për OJF-të nga bashkitë më të mëdha gjatë vitit 2017, vihet re se në përgjithësi, OJF-të trajtohen si biznese. Pra, siç tregohet në tabelën në vijim, ekziston një trajtim i diferencuar vetëm për taksën e pronës (duke përfshirë tatimin mbi ndërtesat dhe tokën bujqësore), ndërsa për dy taksat e tjera (taksën e tabelës dhe taksën e gjelbërimit) i njëjti trajtim aplikohet nga shumica e bashkive.

<sup>25</sup> Ligji nr. 9136, dt. 11.02.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar me ligjin nr.9164, datë 18.12.2003, 9329, datë 6.12.2004, nr.9933, datë 26.6.2008, nr. 10/2012, datë 9.2.2012, 87/2014, datë 17.7.2014, nr. 143/2015, datë 17.12.2015, i ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.60, datë 16.9.2016, akti normativ nr.1, datë 25.1.2017)

<sup>26</sup> Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Ligji nr. 9632, datë 31.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

**Tabela 1. Taksat vendore**

Bashkia	OJF-të			Biznesi i vogël		
	Taksa mbi pronën / Lekë /m2 vit	Taksa e tabelës Lekë / vit	Taksa e Gjellbërimit Lekë / vit	Taksa mbi pronën / Lekë /m2 vit	Taksa e tabelës Lekë / vit	Taksa e Gjellbërimit Lekë / vit
Tiranë	50-100	35,000-45,200	10,000	200-280	35,000-45,200	3,500-10,000
Fier	60	22,500	3,000-5,000	150-300	22,500	10,000-25,000
Shkodër	60	22,500	6,000	60-300	22,500	8,000-13,000
Korçë	60	22,500	20,000 pastrimi 5,000 ndriçimi 5,000 gjellbërimi  Total: 30,000	150-300	22,500-45,000	5,000-15,000 pastrimi 1,000-9,000 ndriçimi 4,000-5,000 gjellbërimi  Total: 10,000-29,000
Vlorë	30-60	22,500-45,000	5,000	75-300	22,500-45,000	5,000-15,000
Durrës	20-100	22,500-45,000	500 pastrimi 500 ndriçimi 1,500 gjellbërimi  Total: 2,000	50-280	22,500-45,000	5,000-20,000 pastrimi 2,000-3,000 ndriçimi 1,500-10,000 gjellbërimi  Total: 8,500-33,000

Kjo situatë në nivel lokal është një reflektim i paqartësisë dhe konfuzionit në trajtimin fiskal të OJF-ve në nivel kombëtar, duke mos i trajtuar ato si një entitet me një natyrë, mision, model financimi, mënyrë veprimi dhe përfitues të veçantë, por duke i trajtuar si biznes. Ky trajtim është gjithashtu evident në ndryshimet e fundit të taksës mbi ndërtesën, miratuar nga qeveria në fund të vitit 2017<sup>27</sup>. Bazuar në këto ndryshime, norma e taksës së ndërtesës nuk do të jetë më një normë fikse, por do të aplikohet si përqindje e bazës tatimore (vlera e ndërtesës), bazuar në dy kategori kryesore, si më poshtë:

- a) 0.05% për ndërtesat e përdorura për banim;
- b) 0.2% për ndërtesat e përdorura për aktivitet ekonomik;

Mbetet akoma e paqartë se si kjo taksë do të llogaritet dhe aplikohet për OJF-të nga bashkitë që kanë autoritetin për të përcaktuar nënkategoritë dhe normat respektive të taksave vendore<sup>28</sup>, duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka asnjë dispozitë në ligj për përfshirjen e OJF-ve në listën e kategorive të përjashtuara nga kjo taksë. Ndërkohë që pronat shtetërore që përdoren për qëllime jofitimprurëse përjashtohen nga taksat e ndërtesës<sup>29</sup>, OJF-të misioni dhe aktiviteti i të cilave janë jofitimprurës, nuk përfshihen në listë.

<sup>27</sup> Ligji 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9632, datë 30.10.2016 "Për taksat vendore", Neni 22/2

<sup>28</sup> Ligji 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9632, datë 30.10.2016 "Për taksat vendore", Neni 5

<sup>29</sup> Idem, Neni 22

**[Rekomandime:]**

- Ndryshimi i ligjit për taksat vendore që të përfshijë një trajtim të veçantë të sektorit të OJF-ve, duke marrë në konsideratë natyrën e tyre jofitimprurëse.

## 6. Trajtimi fiskal i dhurimeve të biznesit dhe individëve

Ligji për organizatat jofitimprurëse u njih të drejtën OJF-ve që të marrin dhurime nga çdo person privat apo publik, shqiptar apo i huaj, por trajtimi tatimor i këtyre dhurimeve nuk është akoma i rregulluar. Shtete në mbarë botën ofrojnë lehtësira tatimore të bazuara në legjislacion për dhurimet, si: zbritje taksash, kredi tatimore apo skema të tjera të përcaktuara sa i përket kontributeve nga individët apo kompanitë për organizatat jofitimprurëse.

Në Shqipëri, vetëm dhurimet në formën e sponsorizimit njihen dhe rregullohen me Ligjin për Sponsorizimet<sup>30</sup>. Ligji njih lehtësi tatimore vetëm për sponsorizimet nga kompanitë private, ndërsa dhurimet individuale nuk njihen dhe si rezultat nuk përfitojnë zbritje taksash.

Sistemi tatimor lejon dhurimet nga 3% deri 5% (në varësi të llojit të veprimtarive të sponsorizuara) të fitimit para tatimit nga subjektet tregtare, si persona fizikë, juridikë, vendas, të huaj ose sipërmarrje të përbashkëta, nivel i cili nuk konsiderohet inkurajues për kompanitë private që të rrisin dhurimet e tyre. Dhurimi njihet nga autoritetet tatimore bazuar në kontratën e sponsorizimit dhe provat e lidhura me sponsorizimin. Lista e veprimtarive të zbritshme është e kufizuar dhe përfshin vetëm veprimtarinë humanitare, kulturore, artistike, sportive, arsimore, mjedisore, vepra letrare, shkencore dhe kërkimore, duke lënë jashtë demokracinë dhe të drejtat e njeriut, si aktivitete kryesore të shumë OJF-ve në interes të publikut.

Kompanitë e huaja mund të aplikojnë gjithashtu për zbritje sipas ligjit, për sponsorizimin e OJF-ve shqiptare, por vetëm nëse janë të regjistruara ligjërisht në institucionet shqiptare dhe gjithashtu nëse dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar. Një mangësi tjetër në ligjin për sponsorizimin është se dhurimet dhe kontributi në natyrë i korporatave nuk njihen si shpenzime të zbritura.

Për shkak të paqartësive dhe mosnjohjes nga inspektorët tatimorë të mjeteve të verifikimit, shpesh dhurimet konsiderohen si një përpjekje për evazion fiskal. Në këto rrethana, shumë kompani nuk aplikojnë për zbritjet e parashikuara në ligjin për sponsorizimet.

### [Rekomandime:]

Krijimi i një mjedisi mundësues për dhurime korporative dhe individuale, përmes:

- Njohjes së aktivitetit filantropik në kuadrin ligjor për të promovuar dhe rregulluar atë si një aktivitet të dallueshëm ndryshe nga sponsorizimi. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të rriten stimujt fiskalë për dhurimet e korporatave dhe të parashikohen stimuj fiskalë për dhurimet individuale.
- Hartimit të një kuadri rregullator ku të parashikohen stimuj që nxisin partneritetin midis OJF-ve dhe sektorit privat, si dy aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e filantropisë në vend, bazuar në modelet ekzistuese lokale dhe përvojën ndërkombëtare.
- Në një nivel praktik, është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi dhe edukimi i inspektorëve tatimorë mbi aktivitetin filantropik, me qëllim që të shmangen barrierat e mundshme që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti në vend.

<sup>30</sup> Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar

## 7. Kërkesat për raportim nga ana e OJF-ve

Standardet e kontabilitetit dhe rregullat financiare për OJF-të përcaktohen në Ligjin për Kontabilitetin<sup>31</sup>, Ligjin për Inspektimin Financiar Publik<sup>32</sup>, Udhëzimin për mbikëqyrjen e OJF-ve, nga organet tatimore, në funksion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit<sup>33</sup> si dhe Udhëzimin për Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF-të<sup>34</sup>.

Me qëllim unifikimin e raportimit financiar për OJF-të, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka miratuar "Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-fitimprurëse". Ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare duke filluar nga 1 janari 2016. Prandaj, pasqyrat financiare të OJF-ve duhet të përfshijnë dokumentet e mëposhtme: Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e Aktivitetiteve, Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare dhe Shënimet Shpjeguese.

Standardi përcakton specifikime mbi pasqyrat financiare, formatet raportuese të OJF-ve dhe paraqet kërkesa të ndryshme raportimi për OJF-të bazuar në qarkullimin e tyre vjetor. Standardi paraqet kërkesa të thjeshtuara të raportimit për organizatat me të ardhura vjetore nën pesë milionë Lekë. Këto organizata duhet të përgatisin dhe dorëzojnë vetëm pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare me shënimet shpjeguese për llojin e aktivitetit apo shërbimeve të ofruara.

Sipas Ligjit për Kontabilitetin, viti fiskal është i njëjtë me vitin kalendarik. Të gjitha librat e llogarive, dokumentet dhe pasqyrat financiare duhet të ruhen për një periudhë 10 vjeçare bazuan në Ligjin për Kontabilitetin, ndërsa për qëllime tatimore, sipas Ligjit 9920 "Për Procedurat Tatimore" dokumentacioni financiar duhet të ruhet për 5 vjet.

Ndërsa standardi i kontabilitetit për OJF-të ka krijuar lehtësira për OJF-të sa i përket raportimit, problem haset shpesh gjatë kontrolleve tatimore, pasi inspektorët nuk kanë njohuritë e duhura për trajtimin fiskal dhe kërkesat për raportim nga ana e OJF-ve.

### [Rekomandime:]

- Zhvillimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve tatimore. Udhëzues dhe manuale specifike që reflektojnë të gjitha ndryshimet në kuadrin ligjor për trajtimin fiskal të OJF-ve, duke përfshirë raportimin financiar dhe rregullat e kontabilitetit, të hartohen, shpërndahen dhe aplikohen njëjloj në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Tatimore në vend.

<sup>31</sup> Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

<sup>32</sup> Ligji Nr. 112/2015 "Për inspektimin financiar publik"

<sup>33</sup> Udhëzimi nr.22, date 19.11.2014, "Për mbikëqyrjen e OJF-ve, nga organet tatimore, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"

<sup>34</sup> Udhëzimi nr. 62, datë 17.9.2015. "Për shpalljen e Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të OJF-ve"

## 8. Detyrimet e OJF-ve ndaj Administratës Tatimore

Në përgjithësi, rregullat e aplikueshme për OJF-të janë konsideruar komplekse dhe të vështira për t'u kuptuar. Si rezultat, OJF-të, sidomos ato të vogla dhe të sapokrijuara e kanë të vështirë t'i zbatojnë.

Në rast të mosplotësimit të afateve ligjore për deklarim dhe pagesë në kohë të detyrimeve tatimore përgjegjëse, sistemi tatimor krijon automatikisht penalitete sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Disa penalitete të aplikuara për OJF-të janë si më poshtë:

- **Për dorëzim të deklaratës tatimore me vonesë**, OJF-të do të penalizohen me 10,000 Lekë për secilën deklaratë tatimore. Për pagesën me vonesë të një detyrimi tatimor, paguhet një penaltet prej 0.06% të shumës së borxhit të papaguar llogaritur në bazë ditore për periudhën që nuk është bërë pagesa. Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me gjobë të barabartë me 0.06 për qind të shumës së borxhit të papaguar llogaritur në baza ditore për periudhën që nuk është bërë pagesa. Penaltetet për pagesë të vonuar dhe deklarim të pasaktë llogariten për një periudhë deri në 365 ditë kalendarike.

- **Fshehja ose shmangia e pagesës së detyrimeve tatimore përbën evazion fiskal** dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës në shumën e përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte paguar.


Sipas të dhënave zyrtare nga Administrata Tatimore, totali i detyrimeve të papaguara nga sektori i OJF-ve deri në mars 2018 është 248,048,489 Lekë, nga të cilat:

- a) 122,841,848 Lekë janë detyrim principal (TVSH, TF, TB dhe kontributet e Sig. shoqërore etj);
- b) 125,206,641 Lekë janë gjoba, kamatëvonesa dhe interesa.

Edhe këtu, duhet të merret në konsideratë fakti se të dhënat nga Administrata Tatimore nuk janë të sakta, për shkak të problematikave të përmendura në lidhje me regjistrin elektronik të OJF-ve. Pra, shumat e paraqitura më sipër mund të vijnë edhe nga subjekte të tjera, dhe është e pamundur të ofrohet informacion i saktë vetëm për organizatat jofitimprurëse, sipas përcaktimit në ligjin për OJF-të.


### Grafiku nr.7

Borxhi sipas Llojit të Tatimit



## Grafiku nr.8

Detyrimi Total i Sektorit ndaj Administratës Tatimore



**E drejta për të apeluar vendimet administrative tek një organ më i lartë apelues** është e garantuar dhe e rregulluar ligjërisht<sup>35</sup>. Në rast se një organizatë e konsideron të padrejtë një vendim të organeve tatimore, mund ta apelojë zyrtarisht aktin administrativ brenda 30 ditëve nga marrja e tij, pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor që funksionon nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që nga janari 2017. OJF-të, njësoj si subjektet tregtare, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në Ligjin për Procedurat Tatimore përpara apelimit të vendimit të organeve tatimore. Kushti kryesor është detyrimi për të **parapaguar shumën totale të tatimit të vlerësuar** nga drejtoria rajonale në aktin administrativ para ankesës, ose **dorëzimi i një garancie bankare** që do të mbulojë të gjitha detyrimet dhe interesat. Gjodat dhe penaltetet nuk mund të parapagohen apo të sigurohen me garanci bankare. Drejtoria e Apelimit Tatimor ka të drejtë të refuzojë shqyrtimin e ankesës, nëse ky kusht nuk është plotësuar. Kjo gjendje është e vështirë dhe në shumicën e rasteve pothuajse e pamundur për t'u përmbushur nga OJF-të duke marrë parasysh buxhetet e tyre, duke i penguar ato që të ushtrjnë të drejtën e ankimit.

**[Rekomandime:]**

Për shkak të mungesës së mjeteve financiare nga OJF-të për të parapaguar detyrimin e përpara ankimit, duke marrë parasysh natyrën e tyre jofitimprurëse dhe shanset shumë të ulëta që ndonjë bankë e nivelit të dytë do të japë lëshojë një garanci për një organizatë jofitimprurëse, është e domosdoshme të rishikohen kushtet që do të duhet të plotësojnë OJF-të që të mund të apelojnë vendimet administrative. Lehtësimi i procedurës do të lejonte më shumë apeline nga OJF-të dhe do të siguronte më shumë qartësi në perceptimin e detyrimeve shpesh arbitrare si dhe gjobave të vendosura nga inspektorët tatimorë ndaj OJF-ve.

<sup>35</sup> Neni 106-110 i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore" dhe Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008



## 9. Kontrollat Fiskale për OJF-të

### 9.1. Kontrolli operacional

Organizatat jofitimprurëse janë subjekt i “kontrolleve operacionale” nga autoritetet tatimore për detyrimet tatimore përgjegjëse (tatimi mbi të ardhurat personale, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi në burim ose tatime të tjera sipas legjislacionit në fuqi). Bazuar në ndryshimet e vitit 2016 në ligjin për procedurat tatimore<sup>36</sup>, tatimpaguesit duhet të njoftohen së paku 30 ditë para fillimit të një kontrolli të plotë dhe rreth 10 ditë para vizitës fiskale.

Mënyra të reja të analizës së riskut janë zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që prej vitit 2015. Zbatimi i sistemit të ri të Teknologjisë së Informacionit ka përmirësuar përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll, e cila tashmë bazohet kryesisht në analizën e riskut dhe llogaritjet në mënyrë qendrore duke analizuar të gjithë informacionin e mbledhur nga deklarata tatimore të tatimpaguesve.

Bazuar në informacionin zyrtar të Administratës Tatimore, gjithsej 14 OJF kanë qenë subjekt i kontrollit të plotë në periudhën 2016 - 2017. Por duke patur parasysh se regjistri elektronik i administruar nga administrata për organizatat jofitimprurëse nuk është i saktë, analiza e riskut dhe rezultatet e saj për sektorin nuk janë të sakta dhe nuk mund të përdoren. Asnjë informacion mbi rezultatet e këtyre kontrolleve apo problematikave të hasura të mospërbushjes tatimore nga sektori nuk është raportuar nga Administrata Tatimore.

### 9.2. Kontrolli kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit<sup>37</sup>

Kjo është një formë tjetër kontrolli dhe kryhet nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në bashkëpunim me Inspektorët e kontrollit pranë Drejtorive Tatimore Rajonale. Në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse, administrata tatimore:

A) Shqyrton pasqyrat financiare të OJF-ve, analizon dhe mban një regjistër të veçantë për: a) Burimet e financimit, b) Aktivitetin ekonomik të OJF-së, (nëse është i aplikueshëm), c) Përdorimin e fondeve (transaksionet, dokumentacionin) dhe d) Asetet e OJF-ve dhe burimin e krijimit të tyre.

B) Kryen kontroll të plotë<sup>38</sup>, kur kategorizohet “me rrezikshmëri të lartë” dhe përfshin: (1) Identifikimin e burimeve të financimit, marrëveshjet për grantet e marra, marrëveshjet e donacioneve, dokumentimin e tarifave të anëtarësimit; (2) Verifikimin nëse OJF-të kryejnë veprimtari ekonomike dhe nëse gjenerojnë të ardhura nga ky aktivitet; (3) Verifikimin e llogarisë bankare në të cilën transferohen donacionet/fondet; (4) Verifikimi nëse fondet e organizatave jofitimprurëse mbahen në llogaritë bankare dhe nëse transaksionet ose transaksionet financiare që lidhen me këto fonde kryhen nëpërmjet sistemit bankar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi; (5) Kryerjen e detyrave nga organi më i lartë vendimmarrës<sup>39</sup>; (6) Verifikimin nëse fondet përdoren në përputhje me qëllimin e tyre dhe (7) Nëse organizatat jofitimprurëse që kryejnë veprimtari ekonomike dhe gjenerojnë fitime nga ky aktivitet, i përdorin ato për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe aktin e themelimit.

Gjatë konsultimeve me OJF-të, ato raportojnë se kanë qenë subjekt i kontrolleve të shpeshta nga inspektorët tatimorë, e sidomos gjatë fushatave kundër informalitetit të iniciuara nga qeveria gjatë vitit 2016 dhe 2017.

<sup>36</sup> Ndryshimet ligjore me ligjin nr. 112/2016, “Për procedurat Tatimore”

<sup>37</sup> Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22, datë 19.11.2014 “Për mbikëqyrjen e OJF-ve, nga organet tatimore, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, Neni 7

<sup>38</sup> Idem, Neni 8

<sup>39</sup> Neni 20, Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo fitimprurëse”

Këto kontrolle shpesh kanë rezultuar me gjopa të konsiderueshme për organizatat, kryesisht si rezultat i mungesës së njohurisë të inspektorëve për mënyrën e funksionimit të OJF-ve. Ndërkaq, ndonëse OJF-të pranojnë se sjellja dhe komunikimi me inspektorët është përmirësuar ndjeshëm, ende ekzistojnë disa çështje problematike të vazhdueshme si më poshtë:

- Inspektorët tatimorë të drejtorive rajonale të ndryshme, japin interpretime të ndryshme për të njëjtat ligje dhe procedura sa i përket trajtimit të sektorit;
- Ndryshimet e shpeshta të stafit të Administratës Tatimore, sidomos në rrethe, mungesa e trajnimeve specifike dhe stafit të dedikuar për sektorin jofitimprurës pranë drejtorive rajonale, ka ndikuar drejtpërdrejt në veprimtarinë e OJF-ve në të gjithë vendin duke e bërë të vështirë përmbushjen e detyrimeve;
- Nuk ekziston një manual specifik për inspektorët tatimorë që lidhet me kontrollet operationale të sektorit jofitimprurës, si rezultat i mungesës së të kuptuarit të natyrës specifike dhe kuadrit ligjor të sektorit nga ana e inspektorëve tatimorë.

### **[Rekomandime:]**

- Zhvillimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve për inspektorët tatimorë dhe sektorin. Ngritja e grupeve të punës me përfaqësuesit e OJF-ve, administratës tatimore dhe ministrive të linjës ku të diskutohen çështjet tatimore dhe të miratohen programe të përbashkëta trajnimi.

## Aneks 1. Praktikët e rimbursimit të TVSH-së për projektet IPA në rajon<sup>40</sup>

### *Kosovë:*

Në Kosovë<sup>41</sup>, organizatat, të cilat kryejnë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, për projektet e financuara nga BE dhe siç parashikohet në marrëveshjen IPA, kanë të drejtën e rimbursimit të TVSH-së së paguar për blerjet në bazë mujore pavarësisht vlerës së kërkuar.

Organizatat e krijuara në një Shtetet Anëtare të BE-së apo të një shteti tjetër të huaj, që janë gjithashtu palë në projektet e financuara nga IPA (bashkë-aplikantët), nuk janë të detyruar të regjistrohen për qëllime biznesi në Kosovë, në bazë të nenit 26 paragrafi 2 pika d. e Marrëveshjes për IPA-t për furnizimet që financohen drejtpërdrejt nga fondet e BE-së.

### *Bosnje dhe Hercegovinë:*

Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve në Bosnje dhe Hercegovinë në kuadër të projekteve të financuara nga Komisioni Evropian përmes IPA-ve përjashtohet nga pagesa e TVSH-së.<sup>42</sup>

Kontraktorët, të financuar nga fonde IPA, do të marrin një numër unik identifikimi në çertifikatën e lëshuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në BiH. Një kopje e çertifikatës së përjashtimit nga TVSH lëshohet nga DBE në BiH, e cila është e vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e projektit dhe gjithashtu shkon tek furnizuesi/ofruesi (përmes zyrës së DBE). Çdo faturë duhet të përmbajë numrin unik të çertifikatës së përjashtimit nga TVSH.

### *Serbia:*

Projektet e financuara nga projektet IPA, kombëtare dhe ndërkombëtare janë të përjashtuar nga TVSH-ja në Serbi. Si aplikantët kryesorë ashtu edhe partnerët e projektit janë të përjashtuar nga TVSH për projektet e financuara nga BE, me dorëzimin e dokumenteve të kërkuara brenda legjislacionit përkatës<sup>43</sup>.

Në Serbi, procedura e përjashtimit nga TVSH-ja për një Projekt të financuar nga BE është mjaft e thjeshtë:

Organizata paraqet kontratën e grantit me Komisionin e BE-së pranë Delegacionit të BE-së në Serbi. (Në rastin e projekteve të zbatuara në më shumë se një vend, dokumentacioni duhet të dërgohet në DBE të secilit vend partner të projektit). DBE do të dorëzojë një listë të projekteve të reja, organizatave dhe të gjitha kontratave të projektit në zyrën e Administratës Tatimore një herë në muaj, në ditën e pestë të muajit. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Serbisë është përgjegjës për krijimin dhe përditësimin e një liste të projekteve dhe dhënien e saj Administratës Tatimore.

Kopja e Kontratës së Projektit, lista e emrave të personave përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të TVSH-së dhe Nënshkrimit (specimenin) e personave përgjegjës për nënshkrimin e formularëve të përjashtimit nga TVSH-ja, duhet të jepen vetëm në fillim tek Administrata Tatimore, ndërkohë që kopja e Kontratës së Projektit do të dërgohet në emër të organizatës nga Delegacioni i BE-së dhe procedura e përjashtimit nga TVSH-ja përfundon këtu.

<sup>40</sup> Udhëzim për procedurën dhe përjashtimin e TVSH-së për projektet e financuara nga IPA – Janar 2016

<sup>41</sup> <http://www.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2017/08/Rregullore-e-Brendshme-per-Procedurat-e-rimbursimit-te-TVSH-se2c-TAP-dhe-TAK-1.pdf>

<sup>42</sup> <http://www.uino.gov.ba/doenload/Dokumenti/Dokumenti/eng/Porezi/PDV/Instruction%20IPA.pdf>

<sup>43</sup> <http://www.poreskauprava.gov.rs/en.html>

